



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 043

Prishtinë, më 6 dhe 7 nëntor 2008, në orën 10:0

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 6 DHE 7 NËNTOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 84 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Deputetja Besa Gaxheri (LDD) kërkoi që kuvendi në seancën e sotme të debatojë për Veriun e Kosovës.

Deputeti Esat Brajshori (AKR) kërkoi shpjegime pse nuk është radhitur për shqyrtim Raporti i RTK-së?

Kryetari i GP të LDK-së, Lutfi Haziri, propozoi që pika e 17-të të hiqet nga rendi i ditës.

Deputeti Driton Tali kërkoi që Kuvendi të debatojë lidhur me Marrëveshjen ndërmjet PTK-së dhe Kompanisë “Dardania”, si dhe të ritransmehotet debati nga seanca e kaluar lidhur me Trustin e Pensioneve.

Deputeti Naim Maloku (AAK) propozoi që në seancën e sotme të debatohet lidhur me ndodhitë në komunën e Kaçanikut.

Deputeti Fatmir Rexhepi (LDK) kërkoi nga Qeveria e Kosovës Informatë të plotë lidhur me gjendjen në Trustin e Pensioneve, si dhe në rend dite të seancave plenare të vendosen temat aktuale.

Deputeti Riza Smaka (AKR) propozoi që të mbahet seancë e veçantë për gjendjen në Trustin e Pensioneve.

Deputeti Naser Rugova (LDD) propozoi që për pikën e 17-të – Trusti i Pensioneve, të mbahet seancë e veçantë.

Deputeti Ahmet Isufi (AAK) kërkoi nga Trusti i Kursimeve Pensinale që të përgatitë një Raport se çka po ndodhë me paratë që menaxhohen nga Trusti.

Kryetari tha se propozimet duhen të parashtrohen në bazë të rregullave procedurale të Kuvendit. Ai kërkoi deklarimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari hodhi në votim propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47;
Kundër-----39;
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash vendosi që pika e 17-të -Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës, të shtyhet për seancën e ardhshme.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 17 tetor 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lizingun financiar,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nr. 03/L-002,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, nr. 03/L-018,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, nr. 02/L-073,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Ansamblin e këngëve dhe të valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera, nr. 03/L-056,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare, nr. 03/L-060.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat, nr. 03/L-077,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produktet për mbrojtjen e bimëve, nr.03/L-042.
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri...për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionin të Konkurrencës,
17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm, dhe
18. Njoftimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 17 tetor 2008

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 17 tetor 2008.

Deputetët Adem Hajdaraj dhe Riza Smaka patën vërejtje në Transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët se për shkak të numrit të madh të pyetjeve të parashtruara, e me qëllim të ruajtjes së aktualitetit të tyre, Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 28 tetor 2008, ka vendosur që Kuvendit t'i propozojë shmangie nga Rregulla 26, pika 1, duke e zgjatur kohën për pyetjet parlamentare në 60 minuta, si dhe duke proceduar me nga një pyetje të secilit deputet që ka shtruar më shumë pyetje. Kjo vlen edhe për seancën e sotme, edhe për atë të nesërmen.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryesisë që koha për pyetje parlamentare për seancën e sotme dhe atë nesërme të jetë nga një (1) orë.

Deputetja **Synavere Rysha** i parashtroi pyetje Ministrit të Ekonomisë dhe Financave lidhur me zjarrin e shkaktuar në objektin e AKM-së.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Rysha**.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtroi pyetje Ministrit të Arsimit lidhur me titujt shkencorë që janë marrë në Universitetin e Prishtinës

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rexhepi.

Deputeti **Driton Tali** i parashtroi pyetje Ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputet Tali.

Deputeti **Riza Smaka** i parashtroi pyetje ministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me dispozitën e nenit 9, paragrafi 1 të Ligjit për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministri **Fehmi Mujota** iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti **Naim Rrustemi** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me doganimin apo konfiskimin e mallrave që blihen në territorin e Kosovës.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Rrustemi.

Deputeti **Naim Maloku** i parashtroi pyetje Ministrin të Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit lidhur me mbikëqyrjen e ndërtimeve të rrugëve, në veçanti të aksit rrugor Fushë Kosovë- Sllatinë.

Ministri **Fatmir Limaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Maloku.

Deputetja Nurishahe Hulaji i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe të Mirëqenies Sociale lidhur me Agjensionin Ekzekutiv të Inspektoriatit të Punës..

Ministri **Nenad Rashiq** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja **Kaqusha Jashari** i parashtroi pyetje Ministrin të Transportit dhe të Post-Telekomunikacionit lidhur me Projektin e autostradës Merdar –Vërmicë.

Ministri Fatmir Limaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Jashari.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me ndikimin e krizës globale financiare në ekonominë e Kosovës

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputetja **Saniye Aliaj** i parashtroi pyetje ministrit të Pushtetit Lokal lidhur me lejet e ndërtimeve në komunën e Ferizajt.

Ministri **Sadri Ferati** iu përgjigj pyetjes së deputetes Alijaj

Kryetari dha pauzë dreke prej orës 11:50 deri në orën 13:30 me arsyetimin se Qeveria e Kosovës ka mbledhje në orën 12,00, kurse 10 minutat e mbetura për pyetje parlamentare do të vazhdojnë nesër, gjithsej 70 minuta.

Në vazhdim, seancën e kryesoi **Sabri Hamti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit..

Ministri i Bujqësisë, **Idriz Vehapi**, tha se qëllimi i këtij projektligji është krijimi i kornizës ligjore, përparimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me përcaktimin e politikave për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural në përgjithësi.

Arsyet për propozimin e këtij projektligji janë: eliminimi i zbrazëtirave ligjore që kanë të bëjnë me objektivat, masat dhe programin e politikave të bujqësisë dhe të zhvillimit rural në bazë të planit për zhvillim rural dhe bujqësor 2007-2013.

Përmbajtja e Projektligjit është radhitur në XI kapituj me gjithsej 32 nene.

Në kapitullin e parë janë të përshkruara dispozitat e përgjithshme.

Në kapitulli e dytë, programi i politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural.

Në kapitulli e tretë, masat e politikës bujqësore,

Në kapitullin e katërt përshkruhen masat e politikës së zhvillimit rural,
Në kapitullin e pestë është struktura institucionale për politikën bujqësore dhe zhvillimin rural,
Në kapitullin e gjashtë përshkruhen bazat e të dhënave dhe të sistemit të informimit,
Në kapitullin e shtatë, format e organizimit të prodhuesve, të përpunuesve dhe të tregtuesve të produkteve bujqësore,
Në kapitullin e tetë, shërbimet publike në bujqësi dhe zhvillim rural,
Në kapitullin e nëntë, mbështetja për hulumtim, arsimim dhe trajnim,
Në kapitulli e dhjetë, ankesat, dhe
Në kapitullin e njëmbëdhjetë janë përfshirë dispozitat përfundimtare.

Projektligji është në harmoni të plotë me legjislacionin e BE-së.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Elhame Hetemi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Myrvete Pantina**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Heset Cakolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Hetem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxhe**, si dhe deputetët **Armend Zemaj**, **Riza Smaka** dhe **Edita Tahiri**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 75,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për faljen

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit..

Ministrja e Drejtësisë, **Nekibe Kelmendi**, tha se Projektligjin për faljen e ka hartuar Ministra e Drejtësisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e drejtësisë.

Dispozitat e këtij projektligji janë në harmoni të plotë me dispozitat e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane dhe të shteteve të tjera demokratike.

Zyrtarët e Ministrisë së Drejtësisë, së bashku me zyrtarët e Qeverisë, të Presidencës dhe me ekspertët ndërkombëtarë, përfshirë EULEX-in, ekspertët amerikanë, USAID-in, ICO-n, në takimet e përbashkëta kanë punuar për hartimin e këtij projektligji në mënyrën më të mirë dhe më profesionale. Me këtë ligj krijohet baza e nevojshme ligjore përmes të cilit Presidenti i

Republikës së Kosovës do ta ushtrojë funksionin e tij ekzekutiv për dhënien e faljes në pajtim me paragrafin 29 të nenit 84 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Miratimi dhe fuqizimi i shpejtë i këtij ligji është në interes të të burgosurve, të familjarëve të tyre dhe shoqërisë tonë në përgjithësi.

Në fund të arsytimit të këtij projektligji, ministrja Kelmendi kërkoi që Kuvendi me procedurë të përshpejtuar ta shqyrtojë dhe miratojë këtë projektligj.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për falje.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për falje dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Hajredin Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët **Sanije Aliaj**, **Eqrem Kryeziu**, **Hydajet Hyseni**, **Riza Smaka**, **Gani Buçinca** dhe **Shkumbin Demaliaj**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për faljen.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropiane, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në pajtim me propozimin e Qeverisë së Kosovës, me procedurë të përshpejtuar, dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, në emër të Ministrisë së Drejtësisë, paraqiti para deputetëve të Kuvendi Projektligjin për mjekësinë ligjore.

Në vazhdim, zëvendëskryeministri **Manaj** tha se arsyeja për nxjerrjen e këtij projektligji është gjendja shumë delikate sa i përket fushës së mjekësisë ligjore. Në Republikën e Kosovës kemi pasur shumë vështirësi për shkak të ekzistimit në mënyrë paralele të Institutit të Mjekësisë Ligjore në njërin anë, i cili ka funksionuar në kuadër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Zyrës për Persona të Zhdukur e Mjekësi Ligjore, të themeluar nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut.

Pos tjerash, ky projektligj synon që të bëhet unifikimi i fushës së mjekësisë ligjore në një organ të vetëm në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, e cila do të ndikojë në përmirësimin e kushteve dhe të shërbimeve në fushën e mjekësisë ligjore.

Projektligji për mjekësinë ligjore rregullon strukturën organizative të mjekësisë ligjore në përgjithësi, duke përfshirë menaxhimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Mjekësinë Ligjore. Ky Projektligj ka për qëllim që të rregullojë në tërësi objektet e ekspertimit në fushën e mjekësisë ligjore, siç janë: personat, kufomat, provat materiale, materiet e çështjeve hetimore gjyqësore, e tjerë.

Ky Projektligj përcakton parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për kryerjen e të gjitha aktiviteteve në fushën e mjekësisë ligjore, për realizimin të gjitha obligimeve që janë të kërkuara nga organet e hetuesisë dhe të drejtësisë.

Ky Projektligj nuk është voluminoz, përmban gjithsej 11 nene, të cilët paraqesin tërë kompozicionin e tij, i cili është hartuar duke respektuar edhe teknikat juridike të hartimit të legjislacionit.

Në vazhdim, seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramadan Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Armend Zemaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Rita Hajzeraj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Adem Salihaj**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Sadik Idriz**, si dhe deputetët **Zylfije Hundozi**, **Naim Rrustemi**, **Naser Rugova**, **Fatmir Rexhepi**, **Hajdin Abazi**, **Riza Smaka dhe Lulzim Zeneli**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 24,
Kundër-----30,
Abstenime----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash nuk e miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e Departamentit të Mjekësisë Ligjore.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për lizingun financiar

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, tha se Qeveria e Kosovës këtë projektligj e ka hartuar për ta plotësuar zbrazësinë ligjore të deritanishme pasi që kjo fushë nuk ka qenë e rregulluar me ligj.

Projektligji trajton lizingun financiar, të drejtat dhe detyrimet e palëve në kontratën përkatëse dhe rregullon marrëdhëniet që lindin nga dhënia me qira financiare dhe të sendeve të luajtshme e të paluajtshme të cilat dallohen me veçoritë e tyre. Nga ana tjetër, zhvillimet e vullshme të marrëdhënieve ekonomike dhe financiare në vend diktojnë nevojën për rregullimin ligjor të tyre.

Me kontratën e lizingut financiar njëra palë detyrohet të vë në dispozicion të palës tjetër për një kohë të caktuar një send të luajtshëm ose të paluajtshëm kundrejt një pagese me afate periodike të përcaktuara në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve.

Sendi duhet të jetë i fituar ose të jetë ndërtuar nga lizingdhënësi, sipas dëshirës dhe përshkrimit të lizingmarrësit dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë në mbarim të afatit të kontratës kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar.

Lizingdhënësi përgjigjet ndaj lizingmarrësit sipas rregullave të përgjithshme për mosdorëzimin e sendit ose vonesën në dorëzimin e tij, si dhe për të metat e sendit. Me marrëveshje mund të parashikohet që lizingmarrësi para se të kërkojë nga lizingdhënësi të drejtat e tij, duhet t'i drejtohet atij që ka dhënë sendin, pra furnizuesit për të drejtat e tij ose të atij që i janë kaluar. Projektligji për lizingun financiar ka 8 krerë dhe 30 nene.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin në parim, të Projektligjit për lizingun financiar.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për lizingun financiar dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Nerxhivane Dauti**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Haki Shatri**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Myfera Sinik**, si dhe deputetët **Fatmir Rexhepi** dhe **Driton Tali**, të cilat janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për lizingun financiar.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet e Financa – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda afatit të përcaktuar me Rregulloren të Punës dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nr. 03/L-002

Kryesuesi, **Sabri Hamiti**, ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, **Bahri Hyseni**, tha se Komisioni në bazë të Vendimit të Kuvendit, ka shqyrtuar Ligjin, të cilin nuk e ka nënshkruar PSSP-ja. Komisioni ka hartuar tri amendamente, me të cilat është harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal të Kosovës.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet 1, 2 dhe 3.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër----- 0,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës, nr. 03/L-002.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003

Kryesuesi ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Bahri Hyseni tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar Ligjin e kthyer nga PSSP-ja dhe ka hartuar amendamente në Kodin e procedurës penale me qëllim të harmonizimit të tij me Kushtetutën e Kosovës. Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----58,
Kundër----- 1,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës, nr. 03/L-003.

9. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, nr. 03/L-018

Kryesuesi ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Agim Veliu tha se Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit për rishqyrtimin e ligjeve të aprovuara në Kuvend, por të pashpallura, e rishqyrtoi Ligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore dhe Kuvendit i rekomandon që ta aprovojë, me amendamentet e propozuara.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

Kuvendi miratoi amendamentet 1 dhe 2.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----64,
Kundër-----0,
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, nr. 03/L-018.

10. Shqyrtimi i Rekomandimit për amendamentimin e Ligjit për ndërprerjen e shtatzënisë, nr. 02/L-073

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Teuta Hadri tha se Komisioni për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të vendimit të Kuvendit ka shqyrtuar Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, i cili ka qenë i miratuar në mandatin e kaluar, mirëpo për shkak të ankesave që i ka pas bërë një grup i deputetëve “6+” dhe të ankesave të tyre, ai nuk është shpallur nga PSSP-ja.

Komisioni ka hartuar amendamente dhe i propozon Kuvendit t’i miratojë.

Kryesuesi i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi miratoi amendamentet 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Ligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----47,
Kundër-----5,
Abstenime-----13.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për ndërprerjen e shtatzënisë, nr. 02/L-073.

11. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për Ansamblin e këngëve dhe të valleve “Shota” dhe për ansamblen e tjera, nr. 03/L-056

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision përgjegjës dhe raportues.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 59;

Kundër----- 2.

Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për Ansamblin e këngëve dhe të valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera, nr. 03/L-056.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancës e sotme në orën 17:45 minuta.

Vazhdim i seancës

Më 7 nëntor 2008

Seancën e kryesoi Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kualifikimet kombëtare, nr. 03/L-060

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision përgjegjës dhe raportues.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin.

Agim Veliu tha se komisioni funksional ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji dhe amendamentet e propozuara janë kornizë e mjaftueshme ligjore për sistemin kombëtar të kualifikimeve, andaj i rekomandon Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për kualifikimet kombëtare me amendamentet e propozuara nga komisioni.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76;

Kundër----- 0.

Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për kualifikimet kombëtare, nr. 03/L-060.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 03/L-077 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme parlamentare dhe të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si komision përgjegjës dhe raportues.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë raportin

Agim Veliu tha se komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Amendamentet e propozuara e shndërrojnë Drejtorinë e Arkivit të Kosovës në Agjenci Shtetërore të Arkivit. Andaj, i ftoj deputetët që ta miratojnë Projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni.

Kryesuesi hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1 dhe 2.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60;
Kundër----- 6.
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin nr. 03/L-077 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2003/7 për lëndën arkivore dhe arkivat.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, nr.03/L-042

Kryesuesi i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij Projektligji, si dhe me raportet e komisioneve të përherëshme parlamentare dhe të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision përgjegjës dhe raportues.

Ai hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e komisionit funksional.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70;
Kundër----- 0.
Abstenime-----1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, nr.03/L-042.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurinë private

Kryesuesi i informoi deputetët me rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri lidhur me procedimin e Projektligjit për sigurinë private.

Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë rekomandimin.

Rrustem Mustafa tha se Projektligji për sigurinë private është miratuar në lexim të parë në Kuvend. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional, ka shqyrtuar këtë projektligj dhe pas shqyrtimit, në konsultim edhe me partnerët ndërkombëtarë, që e

mbështesin punën e komisionit, kemi arritur në përfundim se materia që rregullon ky projektligj duhet të rihartohet. Komisioni ka vendosur që t'i propozojë Kuvendit që Projektligjin për sigurinë private t'ia kthejë propozuesit-Qeverisë së Kosovës, për ripunim.

Kryesuesi hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----71;

Kundër----- 0;

Abstenime-----1.

Kryesia konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që Projektligjin për sigurinë private t'ia kthejë Qeverisë së Kosovës, për ripunim.

16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës

Kryesuesi ftoi kryetarin e Komisionit që ta arsyetojë rekomandimin.

Kryetarja e Komisionit, **Myzejene Selmani**, tha se në bazë të vendimit të Qeverisë së Kosovës, datë 19.8.2008, janë propozuar 10 kandidatë për Komisionin e Konkurrencës. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, sipas procedurave të përcaktuara të Ligjit për konkurrencën në Kosovë, ka përzgjedhur pesë(5) kandidatë, të cilët ia propozon Kuvendit që t'i emërojë për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.

Kryesuesi kërkoi deklarinë e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me rekomandimin e Komisionit të cekur më lart.

Pas deklarinës të grupeve parlamentare, kryesuesi e hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----55;

Kundër-----5;

Abstenime-----16.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës

I. Anëtarë të Komisionit të Konkurrencës emërohen:

1. Ahmet Krasniqi,
2. Halit Shabani,
3. Denis Jonuzi,
4. Osman Ejupi, dhe
5. Gani Asllani.

17. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta arsyetojë raportin para deputetëve.

Deputeti **Armend Zemaj**, në emër të Grupit të Punës që kishte hartuar raportin, e arsyetoi atë para deputetëve të Kuvendit.

Deputetja **Besa Gaxheri** propozoi që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës me arsyetimin se ministri i Ekonomisë dhe i Financave nuk ishte i pranishëm në seancë.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e deputetes Gaxheri. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41;

Kundër-----27;

Abstenime----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm, të shtyhet për seancën e radhës.

18. Njoftimi i Grupit Parlamentar të SLS-së për ndërrimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentar të SLS-së, që ka vendosur për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare, si vijon:

Në Komisionin për Punë të Jashtme emërohet deputeti **Dragisha Miriq**, në vend të deputetes Radmila Vujoviq. Gjithashtu, në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor emërohet deputeti **Dragisha Miriq**, në vend të deputetes **Kosara Nikoliq**.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 12:50 minuta

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale

Shënim:

Koha për pyetje parlamentare, që ishte vendosur për fund të seancës, nuk u mbajt ngase mungoni shumica e ministrave të Qeverisë së Kosovës, të cilëve iu ishin parashtruar pyetjet nga ana e deputetëve.